



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 170, datë 06.04.2023

PËR

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 137, datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", Vendimit të KLGJ-së nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, Vendimit nr. 107, datë 04.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me përbërje:
 - Zj. {...}– Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
 - Zj. {...}– Anëtar (Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë);
 - Z. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 - Z. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë);
 - Z. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).
2. Komisioni i Ristrukturimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili ushtron funksionet, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR